



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZLAnr.344/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Fejzullah Rexhepi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krsniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës Birn dhe Internews, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidatës për anëtare të Komunës së Pejës, Ilirjana Gafurri, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017 mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** si e pa rregullt ankesa e Birn dhe Internews, me seli në Prishtinë, me numër ZL.Anr.344/2017 e datës 22.10.2017, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017,

### A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe Internews Kosova, me të cilën pretendon se me datë 22.10.2017 kandidatia për anëtare të kuvedit komunal të Komunës së Pejës, ka bërë fushatë duke shpërndarë fotografi në facebook, duke bërë thirrje për të votuar AAK me përshkrimin “ Obligimin e kryem  $\sqrt{50}$ ,  $\sqrt{9}$ , Fitore për Pejën” duke bërë shkelje të dispozitës së nenit 36.1 a) dhe pika b) të LZP-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një listë në lidhje me rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullësisë së ankesës gjeti se:

#### **Ankesa është e pa rregullt**

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e Birn dhe Internews, me seli në Prishtinë, është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga përfaqësuesi i Birn dhe Internews dhe si tillë ankesa nuk i plotëson kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se “Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtejte të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZLAnr.344/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Rafet Haxhaj**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.